Ne bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 shkronja d), nenit 14, të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale, Ligji Nr.03/L-040, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008", në përputhje me nenin 6 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2, nenin 12, nenin 14, nenin 21 paragrafi 1 nënparagrafi 1.3 dhe paragrafi 2 të Ligjit nr.06/L-092 të dt.07.03.2019 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, në bazë të nenit 5 paragrafi 1.3, nenit 25 dhe nenit 41 të Rregullores së (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 9 të Ligjit për Energjinë nr.05/L-081, Ligjit nr. 08/l-201 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 05/l-081 për energjinë, nenit 22 të Statutit të Komunës së Deçanit, 01.Nr.IX-5, dt.31.10.2019, me propozimin e Kryetarit të Komunës Nr.01-22071, të dt.16.10.2026, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e rregullt të mbajtur me dt.30.10.2026, me 11 vota"për", 6 vota"abstenim" dhe 0 votë"kundër", miratoi këtë:

VENDIM

Për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës KEDS-Sh.a. për vendosjen e Trafoshtyllës në parcelën P-70511069-00074-0, Zk Prapaqan

I.

Aprovohet propozimi i Kryetarit të Komunës dhe merret vendimi për dhënien në shfrytëzim për periudhën afatgjatë prej 40 vite të pronës së paluajtshme të Komunës për rastet e veçanta, shfrytëzuesit KEDS-Sh.a. Divizioni i rrjetit, për vendosjen e Trafoshtyllës, pjesë nga parcela P-70511069-00074-0, Zk Prapaqan, sipërfaqja e dhënë në shfrytëzim është S=4m^2, nga sipërfaqja e përgjithshme e parcelës prej 3071m^2, P.SH. rrugë të pakategorizuara.

II.

Prona e paluajtshme e cekur në nenin 1 të këtij vendimi jepet në shfrytëzim me kompenzim dhe atë 0.50€(zeropikëpesëdhjetëeuro) në muaj për m^2.

III.

Afati kohor për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës, të cekur në nenin 1 të këtij vendimi është 40 vite, duke e ruajtur të drejtën e ndërprerjes së kontratës në raste specifike.

IV.

Mënyra dhe kushtet e shfrytëzimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen me kontratë e cila do të lidhet në mes të Kryetarit të Komunës së Deçanit me përfaqësuesin e KEDS-Sh.a.Divizioni i rrjetit, konform dispozitave të Statutit të Komunës së Deçanit, Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në shfrytëzim dhe Këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës dhe Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për caktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës.

V.

Pas marrjes së këtij vendimi Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër në bashkëpunim me Drejtoratin për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinorë, duhet ta bën parcializimin e sipërfaqes e cila i jepet KEDS-Sh.a. në shfrytëzim dhe të njëjtën t'a regjistroj në librat kadastral si pronë e dhënë në shfrytëzim për periudhën afatgjatë prej 40 vite.

VI.

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Zyra e Kryetarit, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër dhe Drejtorati për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor i Komunës së Deçanit.

VII.

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

VIII.

Me nga një kopje të Vendimit do të paisen: Zyra e Kryetarit, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër, Drejtorati për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor, Arkivi Komunal dhe Kompania KEDS-sh.a.

01.Nr.VIII-3
Deçan,dt.30.10.2026

KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT

Kryesuesi i Kuvendit

Hajdar SUTAJ

REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVA • REPUBLIKA E KOSOVËS • OPSTINA DECANE • DEÇANI MUNICIPALITY • Skupstina Opstine • Asamblea Komunale • Kuvendi Komunal

K.K.Deçan.As 24138
01 05.11.26

PROPOZIM

Ne bazë të nenit 14 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Ligji Nr.03/L-040, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008", në përputhje me nenin 6 paragrafi 1 pika 1.2, nenin 12, nenin 14, nenin 21 paragrafi 1 pika 1.3 dhe paragrafi 2 të Ligjit nr.06/L-092 të dt.07.03.2019 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, në bazë të nenit 5 paragrafi 1.3, nenit 25 paragrafi 1, 3, 4, 6 dhe nenit 41 të Rregullores së (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 9 paragrafi 1 dhe paragrafi 2 të Ligjit për Energjinë nr.05/L-081, Ligjit nr. 08/l-201 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 05/l-081 për energjinë, nenit 22 dhe 55 të Statutit të Komunës së Deçanit, Kryetari i Komunës i propozon Kuvendit të Komunës së Deçanit, në mbledhjen që do të mbahet me dt.30.10.2026, këtë:

PROPOZIM-VENDIM

Për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës për vendosjen e Trafoshtyllës në parcelën P-70511069-00074-0, Zk Prapaqan

I.

I propozohet Kuvendit të Komunës që të merr vendim për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale për vendosjen e Trafoshtyllës në parcelën P-70511069-00074-0, Zk Prapaqan sipas procedurave të përcaktuara me Ligjin nr.06/L-092.

II.

Me rastin e dhënies në shfrytëzim të parcelës së cekur më lartë, marrësi i tokës në shfrytëzim duhet t'i përmbahet Planit Urbanistik dhe legjislacionit në fuqi.

III.

Propozimi i dërgohet Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe marrje të vendimit.

Deçan,dt.16.10.2026

Kryetari i Komunës:
Bashkim Ramosaj

Z.Kryetarit 22071
01 16.10.26

KEDS - SH. A.
Nr. 25310 Dt. 28 SEP 2026

Data	28.09.2026
Për	Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Komuna e Deçanit
Nga:	Divizioni i Rrjeti, Departamenti i Operimit të Sistemit
Lloji i kërkesës	Aplikim për lejim të ndërtimit të punëve elektrike, ndërtimore
Titulli i kërkesës	Shfrytëzimin e parcelës për zhvendosje të trafostacionit
Lokacioni/vendodhja	Fshati Prapaqan, Komuna e Deçanit

PËRMBAJTJA

Në kuadër të mirëmbajtjes së linjave ekzistuese dhe përmirësimin e rrjetit shpërndarës në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës, KEDS ka paraparë zhvendosjen e TS 10(20)/0.4 [kV] Prapaqan 1, 160 [kVA] me kod: 53000002004 për të mundësuar një qasje më të lehtë në operime dhe duke zvogëluar distancën nga konsumatorët që i furnizon. Në mënyrë që të fillojmë procedurat e implementimit të këtij projekti, kërkojmë leje për shfrytëzimin e parcelës me sipërfaqe 4m2, për vendosje të trafoshtyllës në parcelën P-70511069-00074-0: ZK Prapaqani , Komuna e Deçanit.

Qëllimi i projektit konsiston në rritjen e besueshmërisë së furnizimit me energji elektrike në këtë regjion, bazuar në analizat teknike të realizuara nga KEDS gjatë këtij procesi të planifikimit andaj, shpresojmë që bazuar në qëllimin e projektit kërkesa jonë të shqyrtohet pozitivisht.

Kërkesës i bashkëngjitet projekti me të gjitha detajet e paraqitura në hartën topografike, dhe segmentet ku do të zhvendoset trafostacioni.

Personat kontaktues gjatë gjithë këtij procesi do të jenë:

Emri dhe mbiemri	Numri i kontaktit
Xhafer Tishukaj	049 793 420
Egzon Islami	044 492 652
Jeta Kurteshi	049 793 357

Kërkuar nga:
Doruntina Morina
Menaxher për Planifikim të Operimit të Sistemit

KEDS SH.A. PRISHTINË VIII

Aprovuar nga:
Alush Mexhuani
Drejtor i Operimit të Sistemit

KEDS 21072
04 01.10.26

Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor / Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja / Ministry of Environment and Spatial Planning

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-70511069-00074-0

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:	**12/22386/26**
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:	21.10.2026 - 09:55
Komuna / Opština / Municipality:	DEÇAN / DEČANE / DEÇAN
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:	Prapaçan / Prapaçan / Prapaçan
Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:	DEÇAN / DEČANE / DEÇAN

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësisë kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësisë Vrsta Jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-70511069-00074-0	**PARCELË / PARCELA / PARCEL**	Pronë shoqërore / Drushtvena Imovina / Socially owned Land	Rural	**3071**			

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE /CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
GURINA-GURINA	0			

A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcele Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcele Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvalitet klase Quality Class	Sipërfaqja (m²) Površina (m²) Area (m²)
1	Infrastruktura/Infrastruktura/Infrastructure	Rrugë E Pakategor/Nekategorisani Put/UncategorizedRoad		3071

B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licni broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postal Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojedinosti adrese Address details	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Përshkrimi Opis Description	Azhuruar Ažurirano Updated
Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor	**P.SH.RRUGË TE PAKATEGORIZURA**	KCID0508476	PRAPAÇAN / PRAPAÇAN / PRAPAÇAN /			1/1		

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA
MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : DEÇAN

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Prapaçan

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Površina/Area m²
P-70511069-00074-0	Parcelë / Parcela / Parcel	3071



Shkalla/Razmera/Scale: 1:2660

Punoi/Obradio/Created: Besim Elezaj

Nënshkrimi/Potpis/Signature: _____

Shënim/Beleška/Note:

Data/ Data/Date: 21.10.2026

Koha/ Vreme/ Time: 10:04:57